



## Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim  
Odeljenje za Obrazovanje  
Department for Education

-IV. Nr. i prot. 630 Më 14.01.2021  
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC

### PLANI TREMUJOR I PUNËS I DREJTORISË KOMUNALE PËR ARSIM PËR VITIN 2021

Përmes këtij plani, Drejtoria për Arsim për tremujorin e pare të vitit 2021 do të realizojë aktivitetet e shumta me qëllime, synime dhe prioritete të qarta.

#### Qëllimet kryesore të DKA-së janë:

- përmirësimi i kushteve për mësimdhënësie fyrtdhënëse,
- mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor, dhe
- arritja e sukseseve më të mëdha të nxënësve të gjitha niveleve.

#### Synimet kryesore e DKA-së janë:

- Funksionalizimi i plotë Ekipeve për Parandalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve (EPRBM) nëpër shkolla ;
- Funksionalizimi i plotë i aktivave profesionale (AP) në secilën shkollë;
- Riparimet dhe investimet në eficiencë të energjisë në objektet shkollore;
- Përfundimi i investimeve të planikuara në ndërtimin e çerdheve përfëmijë;
- Përfundimi i projekteve përfërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018 dhe 2019;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike, me pakos pedagogjike dhe teknologji informative;

#### Prioritetet themelore të DKA-së për vitin 2021 janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor
- Nxitja e nxënësve përfëtë mësuar përmes organizimit periodik të garave të diturisë në se cilin nivel arsimor.
- Ngritja e cilësisë në arsim

Në tremujorin e parë, përveç që do të analizohet vijueshmëria dhe suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, do të bëhen përgatitjet e nevojshme për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Do t'i mbajmë aktive aktivet profesionale në secilën shkollë, të cilat do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ekipin Profesional Monitorues dhe Vlerësues (EPMV) të DKA-së. Nga Fondi I Kosovës për Eficiencë të Energjisë, presim të fillojë implementimi i projekteve të fituara nga Komuna jonë për zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në 5 shkolla dhe do të zhvillojmë aktivitete kulturore dhe garuese me nxënës për ndër të festive të 17 shkurtit dhe 7 Marsit. Në muajin janar do të nisim procedurën e prokurimit për kontratën e furnizimit të çerdhes për fëmijë me ushqim e piye dhe të gjitha shkollat do t'l pajisim me pakot pedagogjike për mësimdhënësit e klasave 1 deri 5. Në muajin mars do të nisim procedurën për realizimin e kontratës për furnizimin e bibliotekave të shkollave me libra.

Ayni Morina

